



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Datë 23.11.2009

**Vendim**  
**Nr. 130 Datë 23.11.2009**

**“Për disa rekomandime mbi dokumentin e AKEP “Analizë e tregut të telefonisë fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjete fikse: Konsultim publik”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtare
Koço	BROKA	Anëtar
Rezana	KONOMI	Antare

Në mbledhjen e tij të datës 23 /11/ 2009, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e dokumentit të AKEP “Analizë e tregut të telefonisë fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjete fikse: Konsultim publik”

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa f dhe neni 70, pika 2.

**Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:**

- Dokumentit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare “Analizë e tregut të telefonisë fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjete fikse: Konsultim publik”
- Relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës,

## VËREN SE:

- I. Autoriteti i Konkurrencës në mbështetje të ligjeve respektive (LPMK dhe LKE) dhe memorandumit të mirëkuptimit midis AK dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare është fokusuar në disa nga çështjet kryesore të dokumentit “Analizë e tregut të telefonisë fikse” me synim për të kontribuar në dhënien e rekomandimeve që do të rrisnin konkurrencën efektive në tregun e telefonisë fikse.
- II. Nga analiza e këtij dokumenti rezulton se:
  - 1) Albtelekom zotëron mbi 80% të pajtimtarëve dhe të thirrjeve telefonike dalëse dhe mbi 90% të të ardhurave. Pavarësisht se pjesa e tregut të Albtelekom është reduktuar (me ritme shumë të ngadalta), kjo kompani vazhdon të zotërojë mbi 50% të tregut për një periudhë disa vjeçare.
  - 2) Kjo ndërmarrje presumohet se ka pozitë dominuese në treg nëse kjo pjesë tregu ka mbetur e konsoliduar për një periudhë të konsiderueshme kohe. Referuar të gjithë precedentëve të analizuar nga Komisioni Europian, pjesa e tregut mbi 50%, është tregues i padiskutueshëm i ekzistencës së pozitës dominuese në treg.
  - 3) Ndryshimet ligjore i kanë krijuar mundësi Operatorëve Alternativë që të ndërtojnë dhe mirëmbajnë rrjetet lokale dhe të ofrojnë shërbime publike telefonike. Por pavarësisht këtij fakti, hyrja e operatorëve Alternativë në tregun me pakicë të telefonisë ka kosto të lartë. Megjithatë kjo nuk e përjashton mundësinë që Albtelekom pavarësisht pjesës së madhe të tregut të ndeshet me konkurrencë nga operatorë të tjerë.
  - 4) Albtelekom ka ndryshuar tarifat në zbatim të metodologjisë për rregullimin e tarifave të miratuara nga me VKM nr 854, datë 18.06.2008, e cila do të zbatohet për një periudhë dy vjeçare.
  - 5) Edhe pse metodologjia e rregullimit të tarifave ka më se një vit që aplikohet, në tregun e telefonisë fikse ka konkurrencë jo-efektive që rezulton nga tarifat e aplikuara nga Albtelekom. Kjo tarifa për disa shërbime janw mw tw larta dhe për shërbime tw tjera mw tw ulta, krahasuar me nivelin e tarifave që do rezultojnë nëse në treg do ekzistonte një konkurrencë efektive. Aplikimi i këtyre tarifave përbën problem jo vetëm për përdoruesit e Albtelekom por edhe për konkurrentët e tij në treg.
  - 6) Megjithëse miratimi i ofertave të reja referencë të Albtelekom (RIO) ka reduktuar problemet që Albtelekom ka pasur për shërbimin e interkoneksionin, ende vazhdon të ketë probleme në lidhje me shërbime që ndër të tjera mund të përbëjnë abuzim me pozitën dominuese si: “vonesa dhe/ose refuzimi për të dhënë akses në rrjet për shërbimet e interkoneksionit”, “aplikimi i kushteve diskriminuese midis operatorëve të ndryshëm” dhe “aplikimi i kushteve të padrejta në marrëveshje interkoneksioni”. Ky material nuk shprehet në mënyrë të

qartë se cilat sjellje konkrete që mund të përbëjnë abuzim me pozitën dominuese janë konstatuar.

III. Nga analiza e kuadrit ligjor rezulton se:

1. Referuar Ligjit 9121, datë 28.07.2003 'Për mbrojtjen e Konkurrencës' Autoriteti i Konkurrencës ndërhyr kryesisht "ex-post". Por vetë ky Ligj i njeh Autoritetit të Konkurrencës edhe ndërhyrjen "ex-ante", për të cilat shprehet me rekomandimet përkatëse. Sipas nenit 69 të Ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" AK vlerëson të gjitha projekt - aktet normative të cilat mund të kufizojnë apo pengojnë konkurrencën. Në pikën 2 të nenit 70 të Ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" Autoriteti i Konkurrencës, për arsye të interesit të përgjithshëm vlerëson barrierat rregulluese të konkurrencës të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ, duke dhënë rekomandimet përkatëse.
2. Në pikën 3 të nenit 70 të Ligjit Nr. 9121 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" dhe neni 38 të Ligjit Nr. 9918 datë 19. 05. 2008 "Për Komunikimet Elektronike dhe Postare" parashikohen rastet e bashkëpunimit midis Autoritetit të Konkurrencës dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare edhe në rastin e ndërhyrjeve "ex-ante".
3. Ligji "Për Komunikimet Elektronike dhe Postare në RSH" ia ka dhënë të gjitha atributet entit rregullatorit që në analizat ex- ante të dështimeve të tregut të marrë të gjitha masat përkatëse për vendosjen e konkurrencës, duke bashkëpunuar dhe me Autoritetin e Konkurrencës. ndërsa ligji për mbrojtjen e Konkurrencës ka si objekt marrëveshjet e ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese dhe kontrollin e përqendrimeve.

IV. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson bashkëpunimin e vazhdueshëm me AKEP dhe punën e tij mbi analizën e tregut, konkluzionet e draftuara dhe propozimet për ndërhyrje të mëtejshme në rregullimin administrativ të tregut të komunikimeve elektronike.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f dhe nenin 70, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", me propozim të Sekretariatit,

**VENDOSI:**

I. Ti rekomandojë AKEP,

1. Të vazhdojë aplikimin e "Metodologjisë së rregullimit të tarifave" derisa tarifa e thirrjeve kombëtare të jetë e krahasueshme (benchmark) me mesataren e tarifave që aplikohen në vendet rajonit dhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

2. Rregullimin e plotë të tarifave të aplikuara nga Albtelekom duke rritur tarifat që janë nën kosto dhe duke rritur tarifat që janë mbi mesataren e vendeve të rajonit duke i orientuar drejt kostos në mënyrë që të mundësohet një konkurrencë efektive mes operatorëve.
  3. Pas vlerësimit të kostove të Albtelekom në modelin BULRAIC, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare duhet të balancojë tarifat e Albtelekom dhe t'i orientojë drejt kostos. Kjo do të shmangte ofrimin e disa shërbimeve nën kosto që eliminojnë konkurrencën në treg dhe nga ana tjetër do të orientonte drejt çmimeve të drejta disa tarifa që janë te tepruara dhe disa herë më të larta se vendet e rajonit dhe/ose vendet anëtare të Bashkimit Evropian.
- II. Ti kërkojë AKEP që në bazë të nenit 70 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe nenit 38 të ligjit “Për komunikimet elektronike” të vërë në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës, të gjithë dokumentet që zotëron lidhur me abuzimin e mundshëm me Pozitën Dominuese të Albtelekom Sh.A në tregun e telefonisë fikse, të përshkruar në dokument. Ky informacion do të mundësonte hapat e mëtejshme në zbatim të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

## KOMISIONI I KONKURRENCËS

**Servete Gruda**

**Koço Broka**

**Rezana Konomi**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R**